

Data 12.06.2026

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: Marrje me qira automjete pa mundësi blerje

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34100000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 94,796,250 (nëntëdhjetë e katër milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, dhe/ose 998,275.89 (nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e nëntë) Euro pa tvsh;

Llogaritur sipas Kursit Zyrtar të Këmbimit të Bankes së Shqipërisë datë 12.06.2026, ku vlera e Euros është 94.96.

**Argumentimi është mbështetur në pikat 10 dhe 11 të nenit 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, të ndryshuar, ku përcaktohet si më poshtë vijon:**

*10. Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar. Autoriteti/enti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë aplikimin e kontratës shumëvjeçare dhe të bëjë një përlllogaritje të saktë të fondit, ku të jepen hollësi për investimin që do të kryhet, amortizimin për çdo vit dhe përbërësit/elementet e tjera të ngjashme me to.*

*11. Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes qirasë me ose pa mundësi blerje të mallrave, fondi limit llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve, gjatë të cilëve do të zgjasë kontrata.*

Autoriteti Kontraktor argumenton si më poshtë nevojën për lidhjen e një kontrate shumëvjeçare me afat 51 muaj:

Autoriteti Kontraktor, AGS sh.a., është një shoqëri aksionare italo-shqiptare (SNAM S.p.A. 25% dhe Albgaaz sh.a. 75%), e cila ka si mision mirëmbajtjen e gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (TAP) dhe impianteve të lidhura me të në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky aktivitet mbështetet në Kontratën e Mirëmbajtjes, datë 28.12.2018 (e amenduar), e cila është e vlefshme deri më 31.03.2031.

Në funksion të përmbushjes së këtij detyrimi kontraktor afatgjatë dhe të pandërprerë, AGS sh.a. ka nevojë për disponueshmëri të vazhdueshme dhe të garantuar të automjeteve operacionale. Për këtë arsye, është parashikuar zhvillimi i një procedure prokurimi për marrjen me qira operacionale, pa mundësi blerjeje, të automjeteve, ku fondi limit është përlllogaritur në mënyrë të saktë, në përputhje me pikën 11 të nenit 12, si shumëzim i këstit mujor me periudhën 51-mujore.

Përcaktimi i afatit 51 muaj është i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për harmonizimin e kontratës së qirasë me periudhën e mbetur të kontratës bazë me TAP, duke garantuar vazhdimësinë e pandërprerë të shërbimit dhe eliminimin e çdo boshllëku operacional.

Zgjedhja e një kontrate shumëvjeçare rezulton gjithashtu në përputhje me parimin e eficiencës ekonomike dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike, pasishmang kostot e përsëritura të procedurave të shpeshta të prokurimit, redukton kostot operative dhe administrative, siguron kushte më të favorshme ekonomike për shkak të stabilitetit afatgjatë të kontratës, si dhe minimizon rreziqet teknike dhe operative që lidhen me zëvendësimin e shpeshtë të automjeteve dhe transferimin e pajisjeve.

Nga ana tjetër, lidhja e kontratave afatshkurtra (p.sh. 12-mujore) do të ishte në kundërshtim me parimet e mësipërme, pasi do të sillte fragmentarizim të shërbimit, rritje të kostove totale dhe cenim të vazhdimësisë operationale.

Duke marrë në konsideratë natyrën afatgjatë të kontratës bazë me TAP, domosdoshmërinë për garantimin e vazhdimësisë operationale, analizën ekonomike të kostove dhe përfitimeve, si dhe respektimin e kërkesave të nenit 12 të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor vlerëson se lidhja e një kontrate shumëvjeçare me afat 51 muaj është një masë e nevojshme, proporcionale dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

**Argumentimi është mbështetur në Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit si më poshtë vijon:**

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote bazohet në objektin që prokurohet marrja me qira 15 automjeteve pra vetëm e një produkti me specifikime teknike të njëjta.

Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi do të na ofroheshin makina të brendeve të ndryshme cka do të sillte vështirësi në mirëmbajtjen e tyre nga disa operatorë të ndryshëm. Për problemet që mund të lindin eventualisht gjatë zbatimit të kontratës, AK do i duhej të zgjidhte mosmarrëveshjet me dy ose më shumë operatorë dhe kjo mund ta vështirësonte zbatimin e kontratës.

Marrja me qira e automjeteve për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik, pasi ofrimi i tyre nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës në qendrat e mirëmbajtjes dhe gjatë gjurmës së shtrirjes së tubacioneve të gazit.

Per sa më sipër, duke qene se nuk kemi te bejme me mallra te ngjashem por me te njejtin mall dhe referuar nenit 42 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ndarja e kontratës në lote nuk është e mundur. Pavarësisht këtij fakti mosndarja ne lote nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara ne DST janë gjithëpërfshirëse, specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që tu jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. *Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve...*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;*

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e financiare nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontrates.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

### **2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës.

---

*Albanian Gas Service Company Sh.A.*

*RRUGA “KOSOVAREVE”, PALLATI NDERPRO SH.P., TIRANA, ALBANIA*

*NUIS: L82407006D*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e mallrave objekt kontrate, si dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të pasqyrohen datat, shumat dhe mallrat e realizuara;
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të pasqyrohen datat, shumat dhe mallrat e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 40, pika 4, nënpika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të verifikojë që operatorët ekonomikë disponojnë përvojën e nevojshme për të realizuar me sukses kontratën objekt prokurimi. Për këtë arsye, është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 40 % e fondit limit të kontratës, vlerë kjo e vendosur brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni i prokurimit publik.

Përcaktimi i kësaj vlere i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë e arsyeshme se ofertuesit kanë realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në përmasa të mjaftueshme për të garantuar zbatimin e kontratës në afat dhe me cilësi. Përvoja e ngjashme përbën një tregues të rëndësishëm të aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik e për këtë arsye, kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit provues, si vërtetime të lëshuara nga entet publike dhe/ose fatura tatimore të shitjes, është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit, ose ekuivalent.

*Çertifikata e mësipërme duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e shitjes, qirasë dhe mirëmbajtjes së automjeteve pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin

e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin ate.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skeda teknike/data sheet/katalogun e prodhuesit ose fragmente të katalogut për mallin që prokurohet, ku të pasqyrohet dhe të specifikohet qartë automjeti me specifikimet teknike që ofrohen me specifikimet teknike e kërkuara në DT. Fragmentet e katalogut duhet të tregojnë qartë që janë pjesë e katalogut dhe të pasqyrojnë të dhënat teknike, te paktën ato të kërkuara në specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në Ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe në pikën 6 të nenit 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Për të verifikuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike të mallrave të ofruara me specifikimet teknike të kërkuara, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë paraqitjen e katalogëve, skedave teknike ose fragmenteve përkatëse të katalogut të prodhuesit, në mënyrë që të mundësohet vlerësimi i qartë dhe objektiv i ofertës nga komisioni i vlerësimit të ofertave. Kjo kërkesë është në përpjesëtim me objektin e prokurimit, e lidhur ngushtë me të dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

**Argumentimi:** Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, është vendosur në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40, pika 4, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, të cilat i japin të drejtë autoritetit kontraktor të kërkojë nga operatorët ekonomikë dëshmi mbi kapacitetin teknik dhe profesional, kur këto janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me automjetet dhe garantimin e funksionalitetit të tyre gjatë zbatimit të kontratës, paraqitja e kësaj licence shërben për të provuar se operatori ekonomik ushtron ligjërisht veprimtarinë e autoriparimit dhe disponon kapacitetin e nevojshëm teknik e profesional për realizimin e shërbimeve përkatëse.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) ambient/servis për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon disponimin e ambientit/servisit, si certifikatë pronësie/ kontratë qiraje/ kontratë huapërdorjeje, të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) ambient/servis për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, si dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës provues mbi pronësinë ose disponimin e ligjshëm të tij, është vendosur në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40, pika 4, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të verifikojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, në mënyrë të vazhdueshme dhe brenda standardeve të kërkuara. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve gjatë gjithë periudhës së kontratës, disponimi i një ambienti/servisi funksional dhe të ligjshëm është i domosdoshëm për garantimin e ekzekutimit korrekt të saj. Kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) karrotrec, të gatshëm për ofrimin e shërbimit gjatë 24 (njëzet e katër) orëve, për transportin e automjeteve në rast defekti. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion provues për disponimin e karrotrecit, si leje qarkullimi, certifikatë pronësie/ kontratë qiraje/ kontratë huapërdorjeje ose çdo dokument tjetër që provon disponimin e ligjshëm të tij, të vlefshëm për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) karrotrec, të gatshëm për ofrimin e shërbimit 24 orë, është vendosur në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40, pika 4, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon mjetet dhe kapacitetin teknik të nevojshëm për të garantuar ndërhyrje të shpejtë dhe transportimin e automjeteve në rast defekti, avarie ose pamundësie lëvizjeje, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me funksionalitetin dhe vënien në dispozicion të automjeteve, disponimi i një karrotreci është i domosdoshëm për sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit, shmangien e ndërprerjeve dhe garantimin e ekzekutimit korrekt të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën.

*Për përmbushjen e kriterëve të mësipërme 2.2.5 dhe 2.2.6, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e ambientit/servisit dhe të karrotrecit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DT. Ndërsa dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit sipas përcaktimeve të nenit 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar*

*Shënim: Kontrata e qirasë ose e huapërdorjes, nëse paraqitet si dokument provues, duhet të jetë e vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës dhe të lidhura para noterit.*

*Në rastin kur operatori ekonomik mbështetet në kapacitete të subjekteve të tjera, në marrëveshje bashkëpunimi dhe/ose nënkontraktimi, duhet të paraqitet dokumentacioni përkatës sipas legjislacionit të prokurimit publik.*

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.2.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (ky kod është i publikuar në SPE se bashku me DT).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lirë, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favorët e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t’i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

**Shënim:** Dokumentat e tenderit janë hartuar në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast se konstatohet ndonjë mospërputhje ose interpretim i ndryshëm ndërmjet versionit në gjuhën shqipe dhe atij në gjuhën angleze të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), Procesverbalit të Argumentimit ose çdo dokumenti tjetër të procedurës, për efekt interpretimi dhe zbatimi do të prevalojë versioni në gjuhën shqipe.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, AGS sha për automjete Pick-Up 4x4 Double Cab, natyrën e tyre specifike, afatin kohor për realizimin e kësaj qiraje prej 48 muaj, si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40/3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në hartimin e specifikimeve teknike për marrjen me qira pa mundësi blerjeje të automjeteve operacionale Pick-Up 4x4 Double Cab, janë respektuar parimet themelore të prokurimit publik, si transparenca, konkurrenca e lirë, mosdiskriminimi dhe proporcionaliteti.

Në përputhje me nenin 36 të LPP, specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që të përshkruajnë qartë dhe saktë kërkesat funksionale dhe cilësinë e kërkuar të automjeteve, pa kufizuar konkurrencën dhe pa favorizuar një operator ekonomik apo një markë të caktuar. Çdo referencë ndaj standardeve, konfigurimeve apo elementëve teknikë specifikë duhet të interpretohet si “ose ekuivalent”, duke garantuar kështu pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë në treg.

Specifikimet teknike janë përcaktuar bazuar në nevojat reale operacionale të Autoritetit Kontraktor, duke marrë në konsideratë shtrirjen gjeografike të aktivitetit Berat, Fier dhe Korçë, kushtet e ndryshme infrastrukturore dhe segmentet rrugore të amortizuara, nevojën për operim në terrene të vështira dhe jashtë rruge (off-road) kërkesat për siguri, qëndrueshmëri dhe performancë të lartë gjatë përdorimit intensiv.

Për këtë arsye, është përcaktuar si e domosdoshme që automjetet të jenë të kategorisë Pick-Up 4x4 Double Cab, të pajisura me sistem tërheqjeje 4x4, kapacitet të lartë mbajtës dhe tërheqës, si dhe me elementë sigurie dhe asistence në terren. Këto kërkesa nuk janë diskriminuese, por të domosdoshme për realizimin e funksionit operacional dhe për garantimin e vijueshmërisë së shërbimeve. Gjithashtu, parametrat teknikë të përcaktuar (fuqia e motorit, çifti rrotullues, lartësia nga toka, këndet e afrimit/largimit, kapaciteti i tërheqjes, etj.) janë vendosur në nivel minimal të nevojshëm për të përmbushur kushtet reale të përdorimit, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe duke shmangur çdo kërkesë të panevojshme apo kufizuese.

Në përputhje me nenin 77 të LPP dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, kërkesat për mirëmbajtjen, siguracionin, garancinë dhe shërbimet mbështetëse janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë funksionimin e pandërprerë të automjeteve gjatë gjithë periudhës kontraktore, duke minimizuar rrezikun operacional dhe kostot shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Përfshirja e kërkesave për mirëmbajtje të plotë nga operatori ekonomik, siguracion Full KASKO, automjet zëvendësues në rast defekti, asistencë rrugore, dhe përmbushje të detyrimeve ligjore për qarkullim, është po ashtu në përputhje me natyrën e kontratës së marrjes me qira dhe synon garantimin e cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit operacional.